



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 7421 Prot.

Patos, më 04 / 10 / 2024

VENDIM

Nr 26 Datë 29/03 /2024

RAPORTI I VENDIMARRJES SË KËSHILLIT BASHKIAK PATOS PËR VITIN 2023

Mbështetur në piken 3 të nenit 15 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", pika 4 neni 120, *Vlerësimi i Performancës dhe Llogaridhënia e Këshillit dhe Sekretariatit* i rregullores "Për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit të Bashkisë Patos", V.K.B nr. 75 datë 30.11.2023 për miratimin e planit të aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Patos për vitin 2024, Këshilli i Bashkisë i mbledhur më datë 29.03.2024 pasi analizoi projektvendimin e paraqitur nga Kryesia e Këshillit:

VENDOSI

1. Të miratojë raportin e vendimarrjes së Këshillit Bashkiak Patos për vitin 2023.

Numrin total të mbledhjeve.

- Numrin total të mbledhjeve online.
- Numrin e mbledhjeve në sallë.
- Numrin e akteve të miratuara nga këshilli gjatë vitit 2023.
- Numrin e projektvendimeve të kthyera nga këshilli gjatë vitit 2023.
- Informacion të përmbledhur mbi zbatimin e vendimeve nga administrata.
- Numrin e vendimeve të kthyera nga Prefektura.
- Llojet e vendimeve sipas tematikave të tyre.

Referuar sa më sipër Këshilli i Bashkisë gjatë vitit 2023.

- Numri total i mbledhjeve gjatë vitit 2023 është 14.
- Mbledhje të zhvilluara online nuk ka.
- Numri i mbledhjeve të zhvilluara në sallë është 14 të cilat kanë qënë të hapura për publikun. Nga mbledhjet e zhvilluara 12 kanë qënë mbledhje të radhës dhe dy jashtë radhe me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë. Një pjesë të mbledhjeve janë zhvilluar live në faqen e facebook të Këshillit ndërsa pjesa tjetër është e regjistruar me video-audio. Njoftimi i mbledhjeve dhe publikimi është bërë sipas kritereve që përcakton ligji.

- Numrin i akteve të miratuara nga këshilli gjatë vitit 2023 është 85. Nga këto vendime vetëm 15 kanë qënë me karakter normativ dhe 2 vendime nuk kanë qënë me karakter normativ por ligjshmëria e tyre është verifikuar nga Prefekti i Qakut për shkak të parashikimit ligjor ndërsa pjesa tjetër ka qënë me karakter individual dhe kolektiv. Vendimet me karakter normativ i janë dërguar Prefekturës së Qarkut Fier për konfirmim ligjor për të cilat është konfirmuar ligjshmëria ndërsa për një vendim ka ardhur përgjigja se nuk është në përputhje me ligjin, konkretisht vendimi nr. 20 datë 27.03.2023.
- Nuk ka projektvendimeve të kthyer nga këshilli gjatë vitit 2023.
- Zbatimi i vendimeve nga administrata.
Pas zbardhjes së vendimeve ato i kalojnë ekzekutivit për zbatim si dhe në çdo mbledhje pasardhëse është raportuar gjithmonë në lidhje me zbatueshmërinë e tyre. Në pikën e tretë të rendit të ditës është dhënë informacion mbi vendimet e marra nga këshilli, konfirmimet e ligjshmërisë nga prefektura si dhe zbatimi i tyre në administratë.
- Vetëm një vendim është kthyer nga Prefektura ku ka ardhur përgjigja se nuk është në përputhje me ligjin.
- Llojet e vendimeve sipas tematikave të tyre.

Vendime për çështje financiare /tatime/buxheti/ nivel pagash 18.

Vendime për çështje projktesh infrastrukurore 1.

Vendime për çështje urbane dhe pronash 4.

Vendime për çështje sociale, ndihmë ekonomike 33.

Vendime për çështje arsimit , bursa 2.

Vendime për çështje të ndryshme 27.

Njoftim për rendin e ditës si dhe përmbajtja e projektakteve janë publikuar në web si dhe në profilin zyrtar të rrjeteve sociale të këshillit. Të gjitha vendimet pas zbardhjes së tyre janë dërguar platformës Vendime.al e cila është e ndërlidhur dhe me web-in e këshillit. Gjithashtu gjatë vitit 2023 këshilli ka realizuar mbledhje të cilat janë transmetuar live në facebook.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Koordinatorin për të Drejtën e Informimit dhe Sekretari i Këshillit.

3. Ky vendim u shpall në datën 04.04.2024.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI

Armand Ahmetaj